

VENDIM
Nr. 490, datë 18.6.2013

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (1), 31 (tridhjetë e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 378,50 (tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2), 2 (dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 989 (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) m²;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (3), 23 (njëzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 839,26 (tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë presje njëzet e gjashtë) m²;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 2 (dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 438,4 (katërqind e tridhjetë e tetë presje katër) m²;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 346 (treqind e dyzet e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 118 904,30 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e katër presje tridhjetë) m²;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë (1), 44 (dyzet e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 214,40 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e katërmëdhjetë presje dyzet) m²;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë (2), 93 (nëntëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 37 263 (tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) m²;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier (1), 27 (njëzet e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 053,36 (nëntë mijë e pesëdhjetë e tre presje tridhjetë e gjashtë) m²;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 857,3 (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje tre) m²;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (1), 15 (pesëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 497,7 (dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë presje shtatë) m²;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (2), 41 (dyzet e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 601,35 (tetë mijë e gjashtëqind e një presje tridhjetë e pesë) m²;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë, 7 (shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 620,5 (dy mijë e gjashtëqind e njëzet presje pesë) m²;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 050,84 (një mijë e pesëdhjetë presje tetëdhjetë e katër) m²;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 3 (tri) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 989,9 (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë presje nëntë) m²;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 2 (dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 187,8 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë presje tetë) m²;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, 2 (dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 881 (tetëqind e tetëdhjetë e një) m²;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Sarandë, 59 (pesëdhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 21 422,6 (njëzet e një mijë e katërqind e njëzet e dy presje gjashtë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale

nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha